REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 30057 /26
Nr. i fq. / Br. st. –
Data: / Datum: 10.07.2026
VUSHTRRI - VUČITRN

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Vushtrrisë**
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri

---

# Procesverbali nga dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Pantinë, Akrashticë, Balincë, Liqej dhe Oshlan

**Korrik 2026**

**PROCESVERBAL**

Nga dëgjimi publik me qytetarë për përgatitjen e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2027, mbajtur me banorët e Këshillit Lokal Pantinë, që përfshin fshatrat Pantinë, Akrashticë, Balincë, Liqej dhe Oshlan.

**Vendi: Shkolla "Gj.K.Skënderbeu" në Pantinë**

**Ora: 18:00**

**Data: 07.07.2026**

Të pranishëm nga Komuna ishin Qemajl Hasani, zyrtar në Drejtorinë për Financa, Buxhet dhe Thesar, dhe anëtarët e Kuvendit të Komunës, Blerina Shala, Fatmire Cecelia, dhe Diellza Pllana.

**Qemajl Hasani, kryesues,** hapi mbledhjen me qytetarë, ku edhe paraqiti buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2027 dhe projektet e parapara për fshatrat e Këshillit Lokal Pantinë.

Gjithashtu, qytetarëve të pranishëm në këtë dëgjim ju është shpërndarë material informues për buxhetin e vitit 2027.

Më pas fjala ka kaluar tek qytetarët pjesëmarrës në këtë takim për të paraqitur kërkesat e tyre.

**Hamdi Shyti, kryetar i fshatit Oshlan,** paraqiti këto kërkesa:

1. Kolektori kryesor i kanalizimit të vazhdohet edhe të lidhet me kolektorin e Pantinës, si dhe të bëhet kyçja e 4 familjeve në kolektorin kryesor
2. Vendosja e tabelës me emërtimin e fshatit Oshlan
3. Vendosja e ndriçimit publik përgjatë rrugëve të fshatit
4. Vazhdimi i trotuarit
5. Të rregullohet rruga e kategorisë së tretë, rruga "Muharrem Shyti" që ndan fshatin Oshlan me fshatin Pantinë
6. Rregullimi i rrugës afër ujësjellësit
7. Zgjerimi i rrugës "Hazir Gjaka" dhe trajtimi me zhavorr

**Arsim Qungla, banor i fshatit Dolak,** paraqiti këto kërkesa:

1. Ndërtimi i shtëpisë së komunitetit
2. Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës "Halil Kuqi"
3. Rregullimi i rrugës së kategorisë së tretë afër fabrikës së përpunimit të djathit
4. Kyçja e kanalizimit për familjen Kuqi
5. Tek çeshmja e fshatit të bëhet rregullimi i një pllake përkujtimore për luftëtaret e këtij fshati

**Sehare Bajrami, banore e fshatit Pantinë,** paraqiti këto kërkesa:

1. Rregullimi i rrugës me zhavorr për bujqit e rrethit, nga rruga "Bahtir Rexha" deri tek lagjja Imeri
2. Të bëhet vendosja e rrethojës së shkollës në fshatin Pantinë

**Procesmbajtës:**

**Qemajl Hasani**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Vushtrrisë**
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri

---

## LISTA E PJESËMARRËSVE

Dëgjimet buxhetore për draft-buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2027

**Vendi:** Pantinë

**Datë:** 07.07.2026

**Ora:** 18:00

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Nënshkrimi | Vendbanimi |
|---|---|---|---|
| 1 | ARSIM - QUNGLA | [signature] | DOLAK. |
| 2 | Hamdi Shyti | [signature] | Osllan. |
| 3 | Basim Shyti | [signature] | Osllan |
| 4 | Enita Mehmeti | [signature] | Oshlan |
| 5 | Blenima Shala | [signature] | Oshlam |
| 6 | Diellza Pllana | [signature] | |
| 7 | Qemajl Hasani | [signature] | K. Vushtrri |
| 8 | Fatmire Ceadiz | [signature] | K. komunal |
| 9 | Schore Bajrami | [signature] | Pantinë |
| 10 | | | |
| 11 | | | |
| 12 | | | |
| 13 | | | |
| 14 | | | |
| 15 | | | |